
	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosovo/ Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;">Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor</p> <p style="text-align: center;">Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief State Prosecutor</p>	
---	---	---

Raporti 24 orësh i Prokurorit të Shtetit

Prishtinë, 25 Tetor 2020 – Prokurori i Shtetit njofton opinionin se gjatë 24 orëve të fundit me urdhër të prokurorit të shtetit janë ndaluar për 48 orë, gjashtë (6) persona, si dhe janë bërë dy (2) kërkesa për caktimin e paraburgimit ndaj dy (2) personave, të dyshuar se kanë kryer vepra të ndryshme penale.

Gjithashtu, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka bërë tre (3) kërkesa për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të ndryshme, ku nga kërkesa e parë janë sekuestruar:

- një (1) shtëpizë kompjuterike,
- një (1) celularë i tipit Nokia,
- një (1) veturë e tipit Audi A4,
- një SIM kartelë e operatorit IPKO,
- një celularë i tipit Samsung.

Ndërkaq, nga kërkesa e dytë janë sekuestruar përkohësisht:

- një (1) veturë BMW X5,
- çelësi i veturës,
- leja e qarkullimit,
- një (1) celular Samsung,
- një (1) kaçavidë,
- mjete materiale në vlerë prej 161.870.00 funta dhe 26.020.00 euro,
- një (1) çantë në të cilën kanë qenë mjete materiale.

Ndërsa, nga kërkesa e tretë janë sekuestruar përkohësisht: një (1) celularë i tipit IPHONE 8+.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, gjatë 24 orëve të fundit ka bërë tre (3) kërkesa për sekuestrimin e përkohshëm të seneve të ndryshme.

Prokuroria Themelore në Prishtinë, gjatë 24 orëve të fundit, me urdhër të prokurorit kujdestar, ka ndaluar një (1) person të dyshuar dhe ka paraqitur dy (2) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit për dy (2) persona të dyshuar.

Prokuroria Themelore në Pejë, gjatë 24 orëve të fundit, ka ndaluar tre (3) persona të dyshuar për vepra të ndryshme penale.

Prokuroria Themelore në Ferizaj, gjatë 24 orëve të fundit, me urdhër të prokurorit, ka ndaluar dy (2) persona të dyshuar.

Në vijim gjeni raportin e veçuar për secilën prokurori

Prokuroritë	Prokuroria Speciale	Prishtinë	Prizren	Pejë	Gjilan	Gjakovë	Mitrovicë	Ferizaj	Total:
Aktakuzat personat	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ndalimet	-	1	-	3	-	-	-	2	6
Paraburgimet: kërkesat - personat	-	2-2	-	-	-	-	-	-	2-2
Bastisjet	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Sekuestrimet	3	-	-	-	-	-	-	-	3

1. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

Sekuestrimet e përkohshme:

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, gjatë 24 orëve të fundit ka bërë tre (3) kërkesa për sekuestrimin e përkohshëm, ku nga kërkesa e parë janë sekuestruar:

- një (1) shtëpizë kompjuterike,
- një (1) celularë i tipit Nokia,
- një (1) veturë e tipit Audi A4,
- një SIM kartelë e operatorit IPKO,
- një celularë i tipit Samsung.

Ndërkaq, nga kërkesa e dytë janë sekuestruar përkohësisht:

- një (1) veturë BMW X5,
- çelësi i veturës,
- leja e qarkullimit,
- një (1) celular Samsung,
- një (1) kaçavidë,
- mjete materiale në vlerë prej 161.870.00 funta dhe 26.020.00 euro,
- një (1) çantë në të cilën kanë qenë mjete materiale.

Ndërsa, nga kërkesa e tretë janë sekuestruar përkohësisht: një (1) celularë i tipit IPHONE 8+.

2. Prokuroria Themelore Prishtinë:

Ndalimet e personave me urdhër të prokurorit:

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me urdhër të prokurorit kujdestar, ka ndaluar një (1) person, pasi i njëjti dyshohet se ka kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”.

Kërkesat për caktimin e paraburgimit (apo masa tjera):

Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur një (1) kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit për një (1) person, për shkak të dyshimit se i njëjti ka kryer veprën penale “Vjedhja e rëndë ” dhe një (1) kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit për një (1) person, për shkak të dyshimit se i njëjti ka kryer veprën penale “Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale”.

3. Prokuroria Themelore Prizren:

///////

4. Prokuroria Themelore Pejë:**Ndalimet nga Prokurori i Shtetit:**

Prokuroria Themelore në Pejë, gjatë 24 orëve të fundit, ka ndaluar tre (3) persona të dyshuar . Një (1) person është ndaluar për veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, Një (1) person është ndaluar për veprën penale “Rrezikimi i trafikut publik” dhe një (1) person tjetër nën dyshimin për veprën penale “Pengimi i personit zyrtar”.

5. Prokuroria Themelore Gjilan:

///////

6. Prokuroria Themelore në Gjakovë:

///////

7. Prokuroria Themelore në Mitrovicë:

//////

8. Prokuroria Themelore në Ferizaj:

Ndalimet e personave me urdhër të prokurorit:

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me urdhër të prokurorit kujdestar, ka ndaluar në kohëzgjatje prej 48 orësh, dy (2) persona, nën dyshimin se të njëjtit kanë kryer veprën penale “Lëndim i lehtë trupor”.